



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**RREGULLORE**

**MBI  
INVESTIMET, HUADHËNIEN DHE HUAMARRJEN E SIPËRMARRJEVE TË  
LICENCUARA TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

*Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 106, datë 30.06.2021*

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave për investimet, huadhënien dhe huamarrjen e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të licencuara në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2  
Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet për :

1. Sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike që janë licencuar në Republikën e Shqipërisë;
2. Nën-fondin e sipërmarrjes së investimeve kolektive të licencuar në Republikën e Shqipërisë;
3. Sipërmarrjen furnizuese të licencuar të investimeve kolektive si pjesë e strukturës së sipërmarrjes kryesore - furnizuese.

### Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të pikës 9 dhe 10 të nenit 137, 138, 139, 140, 141, 143 dhe neni 144 të Ligjit nr. 56/2020 “Mbi sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

### Neni 4 Përkufizimet

Të gjitha përkufizimet e kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” të referuar në këtë rregullore si “Ligj”. Për qëllime të kësaj rregulloreje me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. **“Treg aktiv”** është tregu në të cilin transaksionet për aktivin ose detyrimin kryhen me frekuencë të mjaftueshme dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në mënyrë të vazhdueshme<sup>1</sup>.
2. **“Risku i likuiditetit”** është rreziku i humbjes kur një pozicion aktiv në portofolin e fondit nuk mund të shitet, likuidohet apo mbyllet me kosto sa më të ulët brenda një kohe mjaftueshmërisht të shkurtër, duke vënë në rrezik në këtë mënyrë aftësinë e fondit për të përmbushur detyrimet e tij për shlyerje, të përcaktuara në prospektin e SIK.
3. **“Risku i Tregut”** është rreziku që lind nga luhatjet në vlerën e tregut të pozicioneve në portofolin e fondeve që lidhen me ndryshimet në variabla të tregut, siç janë normat e interesit, kurset e këmbimit valutor, çmimet e aksioneve dhe të mallrave apo vlerësimi i rrezikut të kreditit të emetuesit.
4. **“Aktivet Likuide të Cilësisë së Lartë” (ALCL)** janë ato aktive që kanë një histori të dëshmuar likuiditeti, si në kushte normale të tregut ashtu dhe në kushte të një tensioni të lartë në treg. Më poshtë është një listë joshteruese e ALCL:
  - a) Mjetet monetare ose depozitat të cilat mund të tërhiqen pa penalitet;
  - b) Ekspozimet ndaj bankave të licencuara nga një bankë qendrore ose rregullatorë të tjerë bankarë në formën e instrumenteve të tregut të parasë ose depozita me një maturim të mbetur deri në 7 ditë;
  - c) Marrëveshjet e anasjellta të riblerjes me një maturim të mbetur deri në 14 ditë, me kusht që titujt e vendosur si kolateral sipas marrëveshjes të anasjelltë të riblerjes përmbushin kriteret e mëposhtme:

---

<sup>1</sup> Është tregu i cili plotëson kriteret e nenit 26 të rregullores nr. 2 datë 27.01.2020 “Për funksionimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në R. Sh. nga shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët” si dhe shtojcës 2 të saj.

- i) Titujt të qeverisë shqiptare me një maturim të mbetur deri në 180 ditë; ose
  - ii) Titujt e transferueshëm në mënyrë që të përmbushë kriterin e përcaktuar në shkronjat (d) dhe (dh) të kësaj pike;
  - iii) Aktive për të cilat dëshmohet se sasi të mjaftueshme të tyre mund të vendosen si kolateral nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes ose lehtësive kredituese midis sipërmarrjes së investimeve kolektive dhe Bankës së Shqipërisë, të cilat nuk janë subjekt i kufizimeve shtesë në rrethana tensioni të përgjithshëm në treg.
- ç) Obligacione qeveritare ose bono thesari me një maturim të mbetur deri në 1 muaj duke përfshirë kuponat;
- d) Titujt e transferueshëm që përfaqësojnë të drejta kundrejt ose të drejta të garantuara nga:
- i) Qeveritë qendrore, bankat qendrore dhe subjekte të sektorit shtetëror të cilat nuk janë njësi të qeverisjes qendrore, të vendeve anëtare të OECD-së, me një vlerësim afatgjatë të kreditit të vendit sipas S&P të paktën BBB- ose vlerësimet ekuivalente të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;
  - ii) Qeveritë qendrore, bankat qendrore dhe subjektet e sektorit shtetëror të cilat nuk janë njësi të qeverisjes qendrore të shteteve të tjera, me vlerësim krediti afatgjatë të vendit sipas S&P jo më pak se A+, ose vlerësimin ekuivalent të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;
  - iii) Institucionet financiare në formën e obligacioneve të garantuara me kolateral (*covered bonds*) për aq kohë sa përmbushen kriteret e mëposhtme: obligacionet kanë një vlerësim S&P afatgjatë A + ose vlerësimin ekuivalent të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;
  - iv) Banka për Shlyerjet Ndërkombëtare (BIS Basel), Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe bankat shumëpalëshe të zhvillimit dhe të tjera si:
    - Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD);
    - Banka Evropiane e Investimeve (EIB);
    - Banka Islamike për Zhvillim (ISDB);
    - Banka Aziatike për Zhvillim (ADB);
    - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH);
    - CAF - Banka për Zhvillim për Amerikën Latine (CAF);
    - Grupi Ndër-Amerikan Bankar për Zhvillim (IDB, IADB);
    - Banka Afrikane për Zhvillim (AFDB);
    - Banka Aziatike e Investimeve Infrastrukturore (AIIB).
  - v) Fondi Evropian për Stabilitetin Financiar (EFSF) dhe Mekanizmi për Stabilitetin Evropian (ESM);
- dh) Emetimet e korporatave si tituj borxhi kur këto plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:
- i) Kanë një vlerësim afatgjatë të S&P të BBB- ose vlerësimet ekuivalente të kreditimit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht;

- ii) Pranojen për tregtim në një bursë të njohur ose një platformë tregtare shumëpalëshe.
  - e) Emetuesit e korporatave në formën e aksioneve, me kusht që aksionet të jenë përbërës të një indeksi që përfshin shoqëritë më të mëdha në një vend anëtar të OECD;
  - ë) Derivatët e tregtueshëm në bursa të cilat tregtohen në tregjet e rregulluara që kanë një mekanizëm kleringu në përputhje me pikën 72 të nenit 4 (1) të Rregullores (BE) nr. 575/2013, ndryshuar; dhe tregjet e rregulluara që kanë një mekanizëm kleringu ku kontratat e listuara në Shtojcën II të Rregullores (BE) nr. 575/2013, ndryshuar tregtohen dhe u nënshtrohen kërkesave të marzhit ditor që sigurojnë mbrojtje të përshtatshme sipas opinionit të autoriteteve kompetente në përputhje me pikën 72 të nenit 4 (1) të Rregullores (BE) nr. 575/2013, ndryshuar.
  - f) Kuotat ose aksionet në sipërmarrjet e investimeve kolektive të cilat cilësohen si SIKTT sipas Ligjit dhe kësaj Rregullore ose UCITS sipas Direktivës 2009/65/KE të cilat mund të shlyhen në çdo ditë pune, ose kuota/aksione në fonde të mbyllura me ofertë publike të krijuara si shoqëri aksionare dhe të pranuar për tregtim në një bursë të rregulluar ose një platformë shumëpalëshe të tregtimit (MTF) e cila është treg aktiv.
5. **“Problemet financiare”** është një situatë kur një kompani nuk mund të plotësojë ose ka vështirësi në shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj kreditorëve të saj.
  6. **“Prova e rezistencës” (Stress testing)** është një teknikë simulimi që përdoret për portofolat e aktiveve dhe të detyrimeve për të përcaktuar ndikimin në to në raport me gjendje të ndryshme financiare. Provat janë modele simulimi që testojnë reagimin sipas skenarëve hipotetikë.
  7. **“Titull bazë” (Underlying security)**, është termi që përdoret në tregtimin e derivateve, për të treguar aktivin apo titullin në të cilin bazohet derivati. Aktivin apo detyrimi është instrumenti financiar bazë, i tillë si një aksion, mall, monedhë, indeks, kontratë standarde të së ardhmes (futures), në çmimin e të cilit bazohet çmimi i derivatit.
  8. **“Plani i kontingjencës”** është dokumenti i miratuar nga shoqëria administruese, që përcakton qartë politikën dhe procedurat që duhet të zbatohen në një situatë krize dhe ngritjen e fondeve emergjente.
  9. **“I pa bllokuar” (unencumbered)** do të thotë pa kufizime ligjore, rregullatore, kontraktuale ose të tjera mbi aftësinë e shoqërisë administruese për likuidimin, shitjen, transferimin ose caktimin e aktivit.
  10. **“Tregu i njohur i derivativëve”** është tregu derivativ që plotëson kërkesat e nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe rregullohet nga autoritetet kompetente në çdo vend anëtar të OECD-së.

11. **“Huamarrje e ndërsjelltë”** (*back to back loan*) është huamarrje paralele, kur dy entitete në vende të ndryshme marrin hua nga njëra tjetra në vlera që kompensojnë njëra tjetrën (*offset*), në monedhat e njëra tjetrës, si një mbrojtje ndaj riskut të monedhës.

## **KREU II**

### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME MBI INVESTIMET, HUADHËNIEN DHE HUAMARRJEN E SIPËRMARRJEVE TË LICENCUARA TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE**

#### **SEKSIONI 1**

#### **INVESTIMET, HUADHËNIA DHE HUAMARRJA**

##### **Neni 5**

##### **Dispozita të përgjithshme mbi investimet, huadhënien dhe huamarrjen**

1. Sipërmarrja e licencuar e investimeve kolektive me ofertë publike investon, si dhe merr e jep hua sipas dispozitave të përcaktuara në Kreun VII të Ligjit dhe në përputhje me këtë rregullore.
2. Sipërmarrja furnizuese e licencuar e investimeve kolektive investon sipas dispozitave të përcaktuara në nenin 144 të Ligjit.
3. Transaksioni në derivativë nuk duhet të ndryshojë objektivat e investimit të sipërmarrjes së licencuar të investimeve kolektive të përcaktuara në dokumentin e themelimit dhe në prospektin SIK të sipërmarrjes.

##### **Neni 6**

##### **Përgjithshmet**

1. Aktivet monetare të mbledhura nuk investohen para kalimit të periudhës së ofertës fillestare, përveçse në formën e depozitës.
2. Kufizimet e përcaktuara në nenin 140 të Ligjit nuk zbatohen për sipërmarrjen e investimeve kolektive të licencuar gjatë gjashtë muajt e parë nisur nga fillimi i periudhës të ofertës fillestare me çmimin e pandryshuar, me kusht që shoqëria administruese e sipërmarrjes së investimeve kolektive të ketë një menaxhim të kujdesshëm të riskut.

##### **Neni 7**

##### **Tregjet e njohura**

1. Tregu i njohur është një treg i rregulluar, i cili duhet të ketë të gjitha karakteristikat e mëposhtme:
  - a) Është treg i autorizuar nga autoritetet kompetente në vendin në të cilin vepron;
  - b) Ka rregulla në lidhje me listimin dhe tregtimin e titujve;
  - c) Vepron rregullisht në ditët e përcaktuara dhe të publikuara brenda orarit të deklaruar;
  - ç) Ka rregulla për njoftimin në kohë të vëllimeve dhe çmimeve të tregtimit;
  - d) Klerimi dhe shlyerja kryhet në strukturat përkatëse;
  - dh) Regjistrimi i pronësisë dhe transferimi i pronësisë kryhet nga strukturat e depozitarit, nën kujdestarit dhe regjistrarit qendror.
2. Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike nuk investon në tituj të transferueshëm nëse këto nuk janë të pranuar për tregtim në një treg të njohur sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Tregu i titujve të Qeverisë Shqiptare konsiderohet treg i njohur.

## **Neni 8**

### **Indekset Financiare**

1. Kërkesat e këtij neni zbatohen për:
  - a) Derivativot që bazohen në indekset financiare;
  - b) SIK me ofertë publike që ndjekin një indeks.
2. Indekset financiare duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Indeksi është mjaftueshëmrisht i diversifikuar;
  - b) Indeksi përfaqëson një pikë referimi të përshtatshme për tregun në të cilin ai i referohet; dhe
  - c) Indeksi publikohet në mënyrë të përshtatshme.
3. Indeksi financiar konsiderohet mjaftueshëmrisht i diversifikuar nëse:
  - a) Është i përbërë në mënyrë të tillë që lëvizjet e çmimeve ose aktivitetet tregtare në lidhje me një komponent nuk ndikojnë në mënyrë të gabuar në ecurinë e tërë indeksit;
  - b) Kur përbëhet nga aktivet në të cilat një sipërmarrje e investimeve kolektive e licencuar lejohet të investojë, përbërja e këtij indeksi është minimalisht e diversifikuar në përputhje me kërkesat në lidhje me menaxhimin e riskut; dhe
  - c) Kur përbëhet nga aktivet në të cilat një sipërmarrje e investimeve kolektive e licencuar nuk lejohet të investojë, është e diversifikuar në përputhje me kërkesat që marrin në konsideratë menaxhimin e riskut të përcaktuar në këtë seksion; dhe
4. Indeksi financiar përfaqëson një pikë referimi të përshtatshme për tregun në të cilin ai i referohet nëse:
  - a) Mat performancën e një grupi përfaqësues titujsh bazë në mënyrën e duhur dhe të përshtatshme;

- b) Rishikohet ose ribalancohet në mënyrë periodike për të siguruar se vazhdon të pasqyrojë tregjet të cilat ajo i referohet, duke ndjekur kriteret të cilat i janë vënë në dispozicion të publikut; dhe
  - c) Titujt bazë janë mjaft likuide, duke i lejuar përdoruesit përsëritjen nëse është e nevojshme.
5. Indeksi publikohet në mënyrë të përshtatshme nëse:
- a) Procesi i publikimit mbështetet në procedura të shëndosha për mbledhjen e çmimeve, dhe përlogarit dhe më pas publikon vlerën e indeksit, duke përfshirë procedurat e çmimeve për komponentët ku nuk ka një çmim tregu; dhe
  - b) Informacioni thelbësor mbi çështje të tilla si llogaritja e indeksit, metodologjia e ribalancimit, ndryshimet e indeksit ose ndonjë vështirësi operacionale në sigurimin e informacionit në kohë dhe të saktë ofrohet gjerësisht dhe në kohë.

## SEKSIONI 2 PËRDORIMI I DERIVATIVËVE

### Neni 11

#### **Përdorimi i derivativëve për menaxhimin efikas të portofolit**

1. Sipërmarrja e licencuar e investimeve kolektive me ofertë publike mund të përdorë derivativë në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregullore. Sipërmarrja e licencuar e investimeve kolektive me ofertë publike:
  - a) Lejohet të përdorë teknika dhe instrumente në lidhje me monedhat, titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë sipas kushteve dhe brenda kufijve të përcaktuar në Ligj dhe në këtë rregullore. Në asnjë rrethanë, këto veprime nuk duhet të shkaktojnë ndryshim të objektivave të sipërmarrjes së investimeve kolektive siç përcaktohet në dokumentin themelues të sipërmarrjes së investimeve kolektive ose në prospektin SIK;
  - b) Garantoni që ekspozimi i saj total në lidhje me instrumentet derivativë nuk e tejkalon vlerën totale neto të portofolit të saj. Ekspozimi llogaritet duke marrë parasysh vlerën aktuale të aktiveve bazë, riskun e palës tjetër, lëvizjet e ardhshme të tregut dhe kohën në dispozicion për të likuiduar pozicionet;
  - c) Mund të investojë, si pjesë e politikës së saj të investimeve dhe brenda kufijve të përcaktuar në këtë rregullore, në instrumentet derivativë, me kusht që ekspozimi ndaj aktiveve bazë të mos kalojë në tërësi kufijtë e investimeve të përcaktuara në këtë rregullore. Kur sipërmarrja e investimeve kolektive investon në instrumente derivativë të bazuar në indeks, këto investime nuk mblidhen në llogaritjen që bëhet për respektimin e kufijve të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Kur titulli i transferueshëm ose instrumenti i tregut të parasë ka të bashkëngjitur (*embeds*) një instrument derivativ, atëherë instrumenti derivativ do të merret parasysh nëse përmbush kërkesat e pikës 6 të nenit 12 të kësaj rregulloreje.

**Neni 12**  
**Transaksionet e lejuara në derivativë dhe kontratat private të së ardhmes**  
**(forward)**

1. Transaksionet duhet të bëhen në ato derivativë që tregtohen në një treg të rregulluar të derivativëve.
2. Aktivi bazë i transaksionit në derivativë konsiston në një ose më shumë nga instrumentet e mëposhtme të lejuar sipas Ligjit, kësaj rregulloreje dhe prospektit të SIK:
  - a) Tituj të transferueshëm;
  - b) Instrumentet e tregut të parasë;
  - c) Depozitat;
  - ç) Derivatvët e lejuar sipas këtij Seksioni;
  - d) Aksionet ose kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive;
  - dh) Indekset financiare që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje;
  - e) Normat e interesit;
  - ë) Kurset e këmbimit valutor; dhe
  - f) Monedhat.
3. Transaksioni në derivativë nuk ndërmerret nëse sipas kushteve të përcaktuar në nenin 13 pikën 1 të kësaj rregulloreje, ka një shitje të zbuluar të një ose më shumë titujve të transferueshëm, instrumente të tregut të parasë, aksione ose kuota në sipërmarrjet e investimeve kolektive ose derivativë.
4. Transaksioni me kontratat private të së ardhmes duhet të kryhet me palë të pranueshme.
5. Për qëllimet e pikës 4 të këtij neni, palë e pranueshme janë klientët profesionistë të përcaktuar në Ligjin “Për Tregjet e Kapitalit”.
6. Derivatvë është instrumenti që plotëson kriteret e mëposhtme:
  - a) Lejon transferimin e riskut të kreditit të aktivit bazë në mënyrë të pavarur nga rreziqet e tjera që lidhen me atë aktiv bazë;
  - b) Nuk rezulton në dhënien ose transferimin e aktiveve të ndryshme nga ato të referuara në nenin 139 të Ligjit ose siç lejohet nga dispozitat e këtij Kreu duke përfshirë mjetet monetare;
  - c) Rreziqet e tij identifikohen në mënyrë të përshtatshme gjatë procesit të administrimit të riskut të shoqërisë administruese të fondeve dhe nga mekanizmat e saj të kontrollit të brendshëm. Këtu përfshihen rreziqet e asimetrisë së informacionit midis shoqërisë administruese të sipërmarrjes dhe kundërpalës në lidhje me derivativët. Këto rreziqe vijnë nga aksesit që mund të ketë kundërpala në informacionit jo-publik mbi subjektet, aktivet e të cilëve janë përdorur si aktiv bazë i atij derivativit.



**Neni 13**  
**Kufizimet në përdorimin e derivativëve**

1. Transaksioni në derivativë ose transaksioni me kontratat private të së ardhmes nuk duhet të kryhet për një sipërmarrje të investimeve kolektive të licencuar me ofertë publike përveç nëse:
  - a) Transaksioni është i llojit të specifikuar në këtë rregullore; dhe
  - b) Transaksioni mbulohet nga aktivet ose mjetet monetare; dhe
  - c) Asnjë element i mbulimit nuk përdoret më shumë se një herë.
2. Kur një sipërmarrje e investimeve kolektive me ofertë publike investon në derivativë, ekspozimi ndaj aktiveve bazë nuk duhet të tejkalojë kufijtë e nenit 140 të Ligjit, përveç rasteve të parashikuara në pikën 4 të këtij neni.
3. Kur titullit të transferueshëm ose instrumentit të tregut të parasë i bashkëngjitet një derivativ, atëherë ky nuk do të merret në konsideratë në llogaritjen e kufijve të investimit të derivativëve sipas nenit 140.
4. Titullit të transferueshëm ose instrumentit të tregut të parasë i bashkëngjitet një derivativ nëse ai përmban një element përbërës i cili plotëson kriteret e mëposhtme:
  - a) Në sajë të këtij përbërësi, disa ose të gjitha flukset e mjeteve monetare që në të kundërt do t'i kërkoheshin titullit të transferueshëm ose instrumentit të tregut të parasë që funksionon si kontratë bazë mund të modifikohen sipas një norme interesi të caktuar, çmimit të instrumentit financiar, kursit të këmbimit, indeksit të çmimeve ose të normave, klasifikimit të kreditit ose të indeksit të kreditit ose të një variable tjetër, dhe prandaj ndryshojnë në një mënyrë të ngjashme me një derivativ më vete;
  - b) Karakteristikat dhe rreziqet e tij ekonomike nuk janë të lidhura ngushtë me karakteristikat ekonomike dhe rreziqet e kontratës bazë;
  - c) Ka një ndikim të rëndësishëm në profilin e riskut dhe çmimin e instrumentit të transferueshëm ose të tregut të parasë.
5. Titullit të transferueshëm ose instrumentit të tregut të parasë nuk i bashkëngjitet një derivativ kur ai përmban një element i cili është i transferueshëm në kontratë në mënyrë të pavarur nga titulli i transferueshëm ose instrumenti i tregut të parasë. Ky element konsiderohet të jetë një instrument i veçantë.
6. Kur sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike investon në një instrument derivativ të bazuar në indeks, me kusht që indeksi përkatës të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 8 të kësaj rregulloreje, titujt bazë të indeksit nuk duhet të merren parasysh kur llogaritet pajtueshmëria me nenin 140 të Ligjit.

**KREU III**  
**KUFIJTË E INVESTIMEVE DHE HUAMARRJES TË ZBATUESHME PËR**  
**FONDET E INVESTIMEVE ME OFERTË PUBLIKE ME PJESËMARRJE TË**  
**HAPUR (JO SIKTT)**

**SEKSIONI 1**  
**DISPOZITA NË LIDHJE ME KUFIJTË E INVESTIMEVE DHE HUAMARRJES**

**Neni 14**  
**Dispozita të përgjithshme**

1. Investimet e fondit të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur përbëhen nga një ose më shumë aktive të lejuara sipas nenit 139 të Ligjit.
2. Huamarrja e fondit të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij Kreu.
3. Menaxhimi i likuiditetit të fondit të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij Kreu.

**Neni 15**  
**Kufizimet në ekspozimet e portofolit të fondeve të investimeve me ofertë publike**  
**me pjesëmarrje të hapur**

1. Fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur duhet të respektojnë kufijtë e ekspozimeve të përcaktuara në nenin 140 të Ligjit.
2. Kufijtë e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohen për fondin e investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, i cili është një fond furnizues dhe gjen rregullim sipas kërkesave të Ligjit.

**Neni 16**  
**Huamarrja për fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur**

1. Fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur mund të blejnë valutë të huaj me anë të huamarrjes së ndërsjellë (*back to back loans*).
2. Fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, mund të marrin hua me kusht që huamarrja të plotësojë kushtet e mëposhtme:
  - a) Në baza të përkohshme, jo më shumë se 90 ditë, dhe nuk përbën më shumë se 10% të vlerës neto të aktiveve të fondit;
  - b) Me anë të marrëveshjeve të riblerjes (*repo*).

## SEKSIONI 2 MENAXHIM I LIKUIDITETIT

### Neni 17 Menaxhimi i likuiditetit

1. Shoqëria administruese zbaton një sistem të përshtatshëm të administrimit të likuiditetit dhe procedura efikase të cilat i përshtaten strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe politikës së shlyerjes për çdo fond që administrojnë.
2. Shoqëria administruese, për secilin fond investimesh me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur që administrojnë, miraton procedura për monitorimin e riskut të likuiditetit dhe kryhen rregullisht provat e rezistencës, në kushte normale dhe të jashtëzakonshme të likuiditetit, të cilat përfshijnë skenarë ekstremë por të besueshëm të rënies së likuiditetit.
3. Sistemi i administrimit të likuiditetit dhe procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, duhet të sigurojnë minimalisht që:
  - a) Shoqëria administruese ruan një nivel të likuiditetit të aktiveve në fondin e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, në përputhje me detyrimet themelore të tij, bazuar në vlerësimin relativ të likuiditetit të aktiveve të fondit të investimit në treg, duke marrë parasysh kohën që nevojitet për shlyerjet dhe çmimin ose vlerën me të cilën këto aktive mund të shlyhen si dhe ndjeshmërinë e tyre ndaj rreziqeve ose faktorëve të tjerë të tregut;
  - b) Shoqëria administruese monitoron profilin e likuiditetit të portofolit të aktiveve të fondit të investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, duke pasur parasysh kontributin e shtuar të aktiveve individuale të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në likuiditetin e fondit, si dhe detyrimet dhe angazhimet materiale, të kushtëzuara ose jo, që fondi i investimit mund të ketë në raport me detyrimet bazë. Për këtë qëllim shoqëria administruese duhet të marrë parasysh profilin e bazës së investitorëve të fondit të investimeve, duke përfshirë llojin e investitorëve, madhësinë relative të investimeve dhe kushtet e shlyerjes ndaj të cilave këto investime janë subjekt;
  - c) Shoqëria administruese, në rastet kur fondi i investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur investon në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive, duhet të kryejë rishikime periodike për të monitoruar ndryshimet në dispozitat e shlyerjeve që kanë sipërmarrjet e investimeve kolektive ku investon fondi i investimeve të cilat mund të ulin likuiditetin e tij;
  - ç) Shoqëria administruese zbaton dhe përditëson rregulla dhe procedura të përshtatshme për matjen e likuiditetit, për të vlerësuar rreziqet sasiore dhe cilësore të pozicioneve dhe investimeve të synuara të cilat kanë një ndikim të konsiderueshëm në profilin e likuiditetit të portofolit të aktiveve të fondit të investimit për të mundësuar matjen në mënyrë të përshtatshme të efekteve të tyre në profilin e përgjithshëm të likuiditetit. Procedurat e përdorura duhet të sigurojnë që shoqëria administruese të ketë njohuritë e duhura për të kuptuar likuiditetin e

aktiveve në të cilat fondi i investimit ka investuar ose synon të investojë duke përfshirë, aty ku është e mundur, vëllimin e tregtimit dhe ndjeshmërinë e çmimeve dhe sipas rastit, diapazonet e çmimeve të aktiveve individuale në kushte likuiditeti normale dhe të jashtëzakonshme;

- d) Shoqëria administruese mban një minimum të aktiveve likuide për çdo fond që administron (ose masa të tjera të miratuara) kur kërkohet nga përcaktimet e nenit 22 të kësaj rregulloreje.
4. Shoqëria administruese duhet të dokumentojë politikën dhe procedurat e administrimit të likuiditetit, t'i rishikojë ato të paktën një herë në vit dhe t'i përditësojë ato sa herë që ka ndryshime ose krijohen rrethana të reja dhe t'i dorëzojë ato pranë Autoritetit, brenda 3-mujorit të parë të vitit.
5. Shoqëria administruese përshkallëzon masat e duhura në sistemin dhe procedurat e administrimit të likuiditetit për të trajtuar si duhet mungesën aktuale ose të pritshme të likuiditetit.

### **Neni 18**

#### **Kufijtë e menaxhimit të likuiditetit**

1. Shoqëria administruese, në rast se duhet, duke marrë parasysh natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e secilit fond investimesh me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur që administron, përdor dhe përditëson kufij të mjaftueshëm për nivelin e likuiditetit ose të aktiveve jo likuide të fondit të investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, në përputhje me detyrimet bazë dhe politikën e shlyerjes, si dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenet 21, 22 dhe 23 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria administruese monitoron përputhshmërinë me këta kufij dhe në rastet kur këto kufij tejkalohen/shkelen ose kanë gjasa të tejkalohen/shkelen, ndërton planin e nevojshëm të veprimit dhe e dërgon menjëherë në Autoritet. Në përcaktimin e veprimeve të përshtatshme, shoqëria administruese duhet të marrë në konsideratë përshtatshmërinë e politikave dhe procedurave të administrimit të likuiditetit, përshtatshmërinë e profilit të likuiditetit të aktiveve të fondit të investimit dhe ndikimin që ka paraqitja e kërkesave për shlyerje në nivele jo të zakonshme.

### **Neni 19**

#### **Prova e rezistencës (*Stress testing*)**

1. Për çdo fond investimi me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur, shoqëria administruese zbaton procedura të përshtatshme të provave të rezistencës për identifikimin e ngjarjeve të mundshme apo ndryshimeve të ardhshme në kushtet ekonomike që mund të kenë efekte të pafavorshme në fondin e investimeve. Shoqëria administruese e fondit të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur

kryen rregullisht provat e rezistencës dhe harton plane veprimi për skenarë të ndryshëm të mundshëm.

2. Provat e rezistencës bazohen në kriteret objektive, duke marrë parasysh skenarë të besueshëm të situatave të rënda dhe ndikimet që kanë ato, si dhe:
  - a) Të kryhen në bazë të informacionit të besueshëm dhe të përditësuar nga ana sasiore ose, kur kjo nuk është e përshtatshme, nga ana cilësore;
  - b) Kur është e përshtatshme, të simulojnë mungesën e likuiditetit të aktiveve në fondin e investimeve dhe kërkesat për shlyerje në nivele jo të zakonshme;
  - c) Të trajtojnë ndryshimet në nivelin e riskut të kreditit të aktiveve të mbajtura në portofolin e fondit të investimit, duke përfshirë ngjarjet e vlerësimit të kreditit;
  - ç) Trajtojnë lëvizjet hipotetike të normave të interesit;
  - d) Trajtojnë rreziqet e tregut dhe çdo ndikim që rezulton, duke përfshirë edhe kërkesë për depozitim shtesë, kërkesat për kolateral apo revokimin e linjave të kreditit;
  - dh) Të marrin parasysh ndjeshmërinë e vlerësimit në kushtet e tensionit; dhe
  - e) Të kryhen më një frekuencë që i përshtatet natyrës së fondit të investimeve, duke marrë parasysh strategjinë e investimeve, profilin e likuiditetit, llojin e investitorit dhe politikat e shlyerjes së fondit të investimit.
3. Modeli i provës së rezistencës të përdorur nga shoqëria administruese raportohet në Autoritet brenda muajit janar të çdo viti. Nëse shoqëria administruese vendos të ndryshojë modelin e provës së rezistencës, raporton në Autoritet brenda 10 ditëve nga miratimi i ndryshimeve.
4. Kur nga provat e rezistencës rezulton se risku i likuiditetit është në masë të konsiderueshme më i lartë se risku i pritshëm i likuiditetit, shoqëria administruese, për të forcuar kapacitetin e likuiditetit, duhet të veprojë në interesin më të mirë të të gjithë investitorëve të fondeve duke marrë parasysh profilin e likuiditetit të aktiveve të fondit, nivelin e kërkesave për shlyerje dhe kur është e përshtatshme mjaftueshmërinë e politikave dhe procedurave për administrimin e likuiditetit.
5. Kur nga provat e rezistencës rezulton ndonjë dobësi në fond, shoqëria administruese e fondit të investimeve merr masat për të forcuar qëndrueshmërinë e fondit të investimeve, duke përfshirë masa që përforcojnë likuiditetin ose cilësinë e aktiveve të fondit të investimeve.
6. Administratorët e fondit i paraqesin këshillit të administrimit të shoqërisë administruese dhe Autoritetit një raport të hollësishëm me rezultatet e provave të rezistencës. Nëse rezulton e nevojshme, këshilli i administrimit ndryshon planin e masave të propozuar dhe miraton planin përfundimtar. Raporti që përshkruan rezultatet e provave të rezistencës dhe plani i masave duhet të hartohen në formë të shkruar dhe duhet të ruhen minimalisht për një periudhë prej pesë (5) vjetësh.

## **Neni 20**

### **Plani i kontigjencës**

1. Shoqëria administruese, për secilin fond me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur që administron krijon një plan kontigjence për menaxhimin e riskut të likuiditetit në kushte të stresuara. Ky plan rishikohet me frekuencë vjetore dhe të përditësohet në përputhje me rrethanat.
2. Plani i kontigjencës duhet të jetë pjesë e politikave dhe procedurave të administrimit të riskut të likuiditetit dhe duhet të përfshijë:
  - a) Specifikimin e qartë të detyrave, kompetencave dhe vendimmarrjes në këndvështrimin e zbatimit praktik;
  - b) Treguesit e paralajmërimit të hershëm të përdorur si sinjale për shfaqjen e një situatë të tensionuar;
  - c) Ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësi të raportimit;
  - ç) Kushtet në të cilat plani duhet të zbatohet;
  - d) Veprimet që mund të ndërmerren;
  - dh) Burimet konkrete të likuiditetit në kushte stresi;
  - e) Komunikimi me aktorët kryesorë, si p.sh. aksionarët, mbajtësit e kuotave, rregullatorët, palët homologe dhe publiku i gjerë.

## **Neni 21**

### **Bashkërendimi i strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe shlyerjeve**

1. Shoqëria administruese e fondit garanton që, për çdo fond investimesh të licencuar me pjesëmarrje të hapur që administron, strategjia e investimit, profili i likuiditetit dhe politika e shlyerjes të jenë të bashkërenduara me njëra tjetrën. Strategjia e investimit, profili i likuiditetit dhe politika e shlyerjes e secilit fond investimi me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur të administruar nga shoqëria administruese, konsiderohen të bashkërenduara kur investitorët mund të shlyejnë investimet e tyre në përputhje me trajtimin e drejtë të të gjithë investitorëve të fondeve të investimit dhe në zbatim të politikës së shlyerjes dhe detyrimeve të fondit.
2. Për të vlerësuar bashkërendimin e strategjisë së investimit, profilit të likuiditetit dhe politikës së shlyerjes, shoqëria administruese duhet të mbajë parasysh edhe ndikimin që mund të kenë shlyerjet në çmimet bazë ose diapazonet e çmimeve të aktiveve të veçanta të fondit të investimit.

## **Neni 22**

### **Kërkesat për të ruajtur nivelin e aktiveve likuide**

1. Fondi i investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur duhet të mbajë në çdo kohë një nivel të mjaftueshëm të ALCL siç përcaktohet në pikën 4 të nenit 4 të kësaj rregulloreje dhe reflekton përbërjen e detyrimeve sipas monedhës, për të dhënë siguri të arsyeshme se fondi është në gjendje të përmbushë:
  - a) Në çdo moment kërkesat për shlyerje, në përputhje me kushtet e përcaktuara në prospektin e fondit;
  - b) Detyrimet e tjera të përcaktuara me ligj, si dhe;
  - c) Detyrimet e tjera, kontraktuale (p.sh. thirrjet e marzhit) mospërmbushja e të cilave sipas detyrimeve dëmton interesat e investitorëve të fondit.
2. Në çdo kohë, niveli i kërkuar i ALCL (rezervë likuiditeti - *liquidity buffer*) i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni nuk duhet të jetë më i vogël se vlera më e lartë e:
  - a) 10% të aktiveve neto të fondit; ose
  - b) Vlera bruto e flukseve dalëse kumulative të tre muajve të fundit deri në datën e llogaritjes, e cila duhet të jetë e përditësuar (flukset hyrëse nuk zbriten për qëllimet e llogaritjes së flukseve dalëse).
3. Aktivitet që përbëjnë rezervën e likuiditetit (*Liquidity Buffer*) mbahen në monedhën në të cilën janë shprehur kuotat e fondit dhe në të cilën kërkohet të kryhen shlyerjet dhe të paktën 50% e rezervës mbahet në mjete monetare dhe/ose instrumente financiare me periudhë të mbetur në maturim jo më të gjatë se 7 ditë dhe pjesa e mbetur 50% mbahet në aktive, të cilat plotësojnë kërkesat e përkufizimit të ALCL në nenin 4, pika 4.
4. Nëse fondi ka më shumë se 50% të aktiveve të tij të investuara në ALCL që përmbushin kërkesat e pikës 4, të nenit 4, të kësaj rregulloreje dhe në rastin e aktiveve të investuara sipas shkronjave (d), (dh), (e) (ë) dhe (f) po të pikës 4, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, të cilat tregtohen në tregje aktive sipas përkufizimit në këtë rregullore atëherë fondi nuk ka detyrim të përmbushë kërkesat e pikës 3, të këtij neni.

### **Neni 23**

#### **Aftësia për të përmbushur kërkesat e likuiditetit**

Për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje, shoqëria administruese e fondit të investimeve me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur të licencuar duhet të sigurojë të gjitha kapacitetet e nevojshme financiare, teknike, organizative dhe burimet njerëzore dhe duhet të rishikojë përshtatshmërinë e tyre në mënyrë të rregullt.

### **Neni 24**

#### **Përputhshmëria me kërkesat e likuiditetit**

1. Pavarësisht nga detyrimi për mbajtjen në çdo kohë të një niveli të ALCL, në periudha tensioni fondi mund të jetë i detyruar të kryejë pagesa të menjëhershme, të cilat mund

të shkaktojnë një rënie në likuiditetin, sipas kërkesave të pikës 2 të nenit 22 të kësaj rregulloreje.

2. Kur niveli i likuiditetit të një fondi investimi me pjesëmarrje të hapur të licencuar bie ose në mënyrë të besueshme pritet të bjerë nën atë limit, shoqëria administruese e fondit duhet të:
  - a) Njoftojë menjëherë Autoritetin;
  - b) Depozitohet menjëherë në Autoritet një plan masash për përmirësimin në kohë të kërkesave të likuiditetit dhe përmbushjes së kërkesave të nenit 22 të kësaj rregulloreje;
  - c) Raportoje në Autoritet çdo ditë deri në fund të ditës së punës, përveç rasteve kur Autoriteti autorizon një shpreshtësi më të ulët raportimi dhe një periudhë më të gjatë të raportimit.
3. Autoriteti monitoron zbatimin e planit të masave, të përcaktuar në shkronjën b) të kësaj pike dhe nëse e gjykon të arsyeshme, kërkon përshtetimin e procesit të rikuperimit.

## **KREU IV**

### **INVESTIMET DHE HUAMARRJA PËR FONDET E INVESTIMEVE ME OFERTË PUBLIKE ME INTERVALE**

#### **SEKSIONI 1**

#### **DISPOZITA NË LIDHJE ME KUFIZIMET NË EKSPOZIMET E PORTOFOLIT**

##### **Neni 25**

##### **Kërkesat për fondet e investimit të licencuara me ofertë publike me intervale**

1. Investimet e fondit të investimeve me ofertë publike me intervale përbëhen nga një ose më shumë aktive të lejuara për fondet me intervale sipas nenit 139 të Ligjit dhe Kreut II të kësaj rregulloreje.
2. Huamarrja e fondit të investimeve me ofertë publike me intervale duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij Kreu.
3. Menaxhimi i likuiditetit nga fondi i investimeve me ofertë publike me intervale duhet të jetë në përputhje me Seksionin 2 të Kreut III të kësaj rregulloreje.

##### **Neni 26**

##### **Kufizimet në ekspozimet e portofolit të fondeve të investimeve me ofertë publike me intervale**



1. Portofolat e fondeve të investimit me ofertë publike duhet të respektojnë kufizimet sipas kërkesave të nenit 140 të Ligjit.
2. Kërkesat e nenit 16 të kësaj rregulloreje zbatohen për huamarrjen e fondeve të investimit me ofertë publike me intervale.

## **KREU V**

### **INVESTIMET DHE HUAMARRJA PËR SIPËRMARRJET KOLEKTIVE TË INVESTIMEVE TË LICENCUARA ME PJESËMARRJE TË MBYLLUR**

#### **SEKSIONI 1**

##### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 27**

##### **Kërkesat për fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur**

1. Investimet e fondeve të investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur përbëhen nga një ose më shumë aktive të lejuara për sipërmarrjet me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur sipas seksioneve 1 dhe 2 të Kreut VII të Ligjit dhe sipas këtij Kreu.
2. Huamarrja për fondet investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur duhet të jenë në përputhje me seksionin 2 të këtij Kreu.
3. Kërkesat e nenit 140 të Ligjit zbatohen për portofolat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive me pjesëmarrje të mbyllur.

#### **SEKSIONI 2**

##### **HUAMARRJA**

#### **Neni 28**

##### **Huamarrja për fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur**

1. Fondet e investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur mund të blejnë valutë të huaj me anë të huamarrjes së ndërsjellë (*back to back loans*).
2. Fondi i investimit me ofertë publike me pjesëmarrje të mbyllur, mund të marrë hua me kusht që huamarrja të jetë në baza të përkohshme dhe të plotësojë kushtet e mëposhtme:
  - a) Jo më shumë se 90 ditë;
  - b) Dhe nuk përbën më shumë se 20% të vlerës neto të aktiveve të fondit.

**KREU VI**  
**INVESTIMET, HUAMARRJA DHE HUADHËNIA PËR SIPËRMARRJET E**  
**INVESTIMEVE KOLEKTIVE NË TITUJ TË TRANSFERUESHËM (SIKTT)**

SEKSIONI 1  
INVESTIMET

**Neni 29**  
**Investimet e Lejuara**

1. Investimet e një fondi SIKTT duhet të jenë në një ose më shumë aktive të lejuara sipas këtij neni si më poshtë:
  - a) Tituj të transferueshëm dhe instrumentat e tregut të parasë të pranuar ose të tregtuara në një treg të rregulluar siç përcaktohet në pikën 95 të nenit 2 të Ligjit 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”;
  - b) Tituj të transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë të tregtuara në një treg tjetër të rregulluar të një vendi anëtar të BE, i cili operon rregullisht, njihet dhe është i hapur për publikun;
  - c) Tituj të transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë të pranuar zyrtarisht për tregtim në një bursë të një vendi tjetër, ose të tregtuara në një treg tjetër të rregulluar të një vendi tjetër të ndryshëm nga ato të parashikuar në pikat a) dhe b) të këtij neni, i cili kryen aktivitet rregullisht, njihet dhe është i hapur për publikun me kusht që bursa të jetë e licencuar nga autoritetet kompetente;
  - d) Tituj të transferueshëm të emtuar së fundmi, me kushtin që:
    - i. Emetimi të përfshijë një kërkesë për pranim në listën zyrtare të një burse të licencuar nga autoritetet kompetente ose të një tregu tjetër të rregulluar i cili operon rregullisht, njihet dhe është i hapur për publikun; dhe
    - ii. Pranimi në tregjet e referuara në pikën (i) të kryhet brenda një viti nga data e emetimit;
  - e) Kuotat e SIKTT të licencuara sipas Ligjit ose UCITS të licencuara sipas Direktivës 2009/65/KE ose në kuota të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive, pavarësisht nëse janë themeluar ose jo në një vend anëtar të BE, me kusht që:
    - i) Sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive janë licencuar/autorizuar në zbatim të ligjeve që konsiderohen nga Autoriteti se ofrojnë të paktën të njëjtën nivel të mbrojtjes së investitorëve si Ligji 56/2020 dhe se bashkëpunimi midis autoriteteve është i mundur;
    - ii) Niveli i mbrojtjes për mbajtësit e kuotave në sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive është i njëjti me atë që ofrohet për mbajtësit e kuotave në një SIKTT/UCITS, dhe në veçanti rregullat për ndarjen e asetëve, huamarrjet, huadhëniet dhe shitjet e pambuluara (*uncovered*) të

- titujve të transferueshëm dhe instrumenteve të tregut të parasë janë të njëjta me kërkesat e Ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
- iii) Raportimet e sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive bëhen minimalisht në periudha gjashtëmujore dhe vjetore në mënyrë që të bëhet një vlerësim i aseteve dhe detyrimeve, dhe të të ardhurave dhe aktivitetit gjatë këtyre periudhave raportuese; dhe
  - iv) Jo më shumë se 10% e aseteve të SIKTT mund të investohet në kuota të një SIKTT tjetër/UCITS ose një sipërmarrje tjetër të investimeve kolektive, kur kjo parashikohet në rregullat e fondit ose instrumentet e themelimit.
- f) Depozitat në banka të cilat janë të pagueshme në momentin e kërkesës ose kanë të drejtë tërheqjeje, me maturim jo më shumë se 12 muaj, me kusht që banka të ketë zyrën e saj të regjistruar në Shqipëri ose një vend anëtar të BE ose jo, me kusht që t'i nënshtrohet rregullave ekuivalente me ato të përcaktuara në ligjin e fushës;
- g) Derivatët, përfshirë instrumentet financiare ekuivalente të shlyerjes së mjeteve monetare (*cash settled*), të tregtuara në një treg të rregulluar referuar në pikat (a), (b) dhe (c) të kësaj pike ose derivativët e tregtuara në (OTC), me kusht që:
- i) Aktivi bazë i derivativit të përbëhet nga instrumentet e mbuluara nga kjo pikë e këtij neni, indekset financiare, normat e interesit, kurset e këmbimit ose valutat, në të cilat SIKTT mund të investojë në përputhje me objektivat e tij të investimit dhe siç përcaktohet në rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit;
  - ii) Palët e treta të transaksioneve të derivateve OTC janë institucione që i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme dhe që i përkasin kategorive të miratuara nga autoriteti ose autoritetet kompetente; dhe
  - iii) Derivatet OTC i nënshtrohen një vlerësimi të besueshëm dhe të verifikueshëm në baza ditore dhe mund të shiten, likuidohen ose mbyllen në çdo kohë me vlerën e tyre të drejtë me iniciativën e SIKTT; ose
- h) Instrumente të tregut të parasë, përveç atyre të tregtuara në tregjet e rregulluara, nëse emetimi ose emetuesi i këtyre instrumenteve është i rregulluar me qëllim mbrojtjen e investitorëve, me kusht që:
- i) Ato të jenë emetuar ose garantuar nga një autoritet qendror, rajonal ose lokal ose, Banka qendrore e një vendi anëtar ose jo, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve, ose nga një organ publik ndërkombëtar të cilit i përkasin një ose më shumë shtete anëtare ose, në rastin e një Shteti Federativ, nga një prej anëtarëve që përbëjnë federatën;
  - ii) Ato të jenë emetuar nga një sipërmarrje, titujt e së cilës tregtohen në tregjet të rregulluara të përmendura në gërmat (a), (b) ose (c) të kësaj pike;
  - iii) Të emetuara ose të garantuara nga një institucion i cili i nënshtrohet mbikëqyrjes së kujdesshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga ligji, ose nga një sipërmarrje e cila i nënshtrohet dhe është në përputhje me rregullat prudente të autoriteteve kompetente të cilat janë të paktën po aq kufizuese sa ato të përcaktuara nga ligji; ose

2. Titujt e transferueshëm duhet të përfshijnë dhe sa vijon:

a) Kuotat në fondet e mbyllura të themeluara si shoqëri investimi ose në formë Trusti që përmbushin kriteret si më poshtë:

- i) Ato përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;
- ii) Ato i nënshtrohen mekanizmave të qeverisjes korporative që aplikohen për shoqëritë;
- iii) Kur veprimtaria e administrimit të aktiveve kryhet nga një entitet tjetër në emër të fondit të mbyllur, ai subjekt është i rregulluar nga Autoriteti kombëtar/vendas për qëllime të mbrojtjes së investitorëve.

b) Kuotat në fondet e mbyllura të krijuara me kontratë dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme:

- i) Ato përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;
- ii) Ato i nënshtrohen mekanizmave të qeverisjes së korporatave ekuivalente me ato të aplikuara për shoqëritë siç referohen në pikën (a) (ii);
- iii) Ato menaxhohen nga një entitet i cili i nënshtrohet ligjeve dhe rregulloreve kombëtare për qëllimin e mbrojtjes së investitorit.

c) Instrumentet financiare që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- i) Ato përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni;
- ii) Ato mbështeten ose lidhen me performancën e asetëve të tjera (p.sh *credit linked bonds*).

3. Titujt e transferueshëm në kuptim të SIKTT do të konsiderohen ato instrumente financiare që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) Humbja e mundshme që SIKTT mund të pësojë në lidhje me mbajtjen e këtyre instrumenteve është e kufizuar në shumën e paguar për to;
- b) Likuiditeti i tyre nuk rrezikon aftësinë e SIKTT për t'u pajtuar me kërkesat e Ligjit në lidhje me shlyerjen e kuotave. Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur në rast se titulli është i pranuar për tregtim në një nga tregjet e rregulluara të përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj rregullore.
- c) Kanë vlerësim të besueshëm i cili bazohet në çmime të sakta, të besueshme dhe të rregullta të cilat mund të jenë ose çmimet e tregut ose çmimet e përlllogaritura nga sisteme vlerësimi të pavarura nga emetuesit;
- d) Ekziston informacioni i përshtatshëm për këto tituj në formën e një informacioni të plotë dhe të saktë për titullin, i marrë nga tregu ose, kur është e nevojshme, për portofolin e titujve;
- e) Ato janë të negociueshme;
- f) Blerja e tyre është në përputhje me objektivat e investimit dhe/ose politikën e investimit të SIKTT;
- g) Rreziqet që lidhen me to janë identifikuar në mënyrën e duhur nga procesi i menaxhimit të rrezikut të SIKTT.

4. Instrumentet e tregut të parasë në kuptim të SIKTT, janë:

- a) Instrumente financiare likuidë të cilat mund të shiten me kosto të kufizuar në një periudhë kohe të shkurtër, duke marrë parasysh detyrimin e SIKTT për të riblerë ose shlyer kuotat e tij me kërkesë të mbajtësit të kotave;

- b) Instrumente financiare vlera e të cilave mund të përcaktohet me saktësi në çdo kohë dhe për të cilët sistemet e vlerësimit të sakta dhe të besueshme plotësojnë kriteret e mëposhtme:
- i) Ata i mundësojnë SIKTT të llogarisë një vlerë neto të aktiveve në përputhje me vlerën në të cilën instrumenti financiar i mbajtur në portofol mund të shkëmbehet midis palëve me informacion, të gatshme për të kryer një transaksion në *arms length*;
  - ii) Ato bazohen ose në të dhënat e tregut ose në modelet e vlerësimit, përfshirë sistemet e bazuara në kostot e amortizuara.
5. Një SIKTT nuk duhet të:
- a) Investojë më shumë se 10% të aktiveve të tij në tituj të transferueshëm ose instrumente të tjera të tregut të parave, të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 1 të këtij neni; ose
  - b) Të blejë metale të çmuara ose certifikata që i përfaqësojnë ato.
6. Një shoqëri investimi SIKTT mund të blejë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, e cila është thelbësore për arritjen e objektivave të biznesit të saj.
7. SIKTT mund të ketë aktive likuide ndihmëse.

## SEKSIONI 2 KUFIZIMET NË EKSPOZIMET E PORTOFOLIT TË SIKTT

### Neni 30 Diversifikimi i portofolit dhe Kufizimet e Investimeve

1. Një SIKTT nuk mund të investojë më shumë se:
  - a) 5 për qind të aktiveve të saj në tituj të transferueshëm dhe/ose instrumente të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm; ose
  - b) 20% të aktiveve të saj në depozita të një emetuesi të vetëm.  
Ekspozimi i riskut ndaj një kundër pale të SIKTT në një transaksion derivativ në OTC nuk duhet të tejkalojë:
    - i) 10% të aktiveve të saj kur kundërpala është një bankë; ose
    - ii) 5% të aktiveve të saj, në raste të tjera.
2. Kufiri 5 për qind, sipas pikës 1 të këtij neni mund të rritet deri në 10 për qind. Në këtë rast, vlera totale e titujve të transferueshëm dhe instrumenteve të tregut të parasë të mbajtura nga një SIKTT në organet emetuese ku në secilin prej tyre investon më shumë se 5% të aktiveve të tij nuk duhet të tejkalojë 40% të vlerës së aktiveve të tij. Ky kufizim nuk zbatohet për depozitat dhe transaksionet derivative OTC të bëra me institucionet financiare që i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme.

3. Pavarësisht nga kufijtë individualë të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, një SIKTT nuk do të kombinojë asnjë nga investimet e mëposhtme, nëse kombinimi do të çonte në investimin e më shumë se 20% të aktiveve të tij në një organ të vetëm emetues:
  - a) Investime në tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parave të emetuara nga i njëjti organ;
  - b) Depozitat në të njëjtën bankë; ose
  - c) Ekspozimet që rrjedhin nga transaksionet e derivateve OTC të ndërmarra nga ai organ.
4. Kufiri i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund arrijë një maksimum prej 35% nëse titujt e transferueshëm ose instrumentet e tregut të parave janë emetuar ose garantuar nga një vend anëtar i Bashkimit Evropian, nga autoritetet e tij lokale publike, nga një vend jo-anëtar me kusht që titujt e vendit jo-anëtar të klasifikohen si ALCL sipas kësaj rregulloreje, ose nga organe publike ndërkombëtare të cilat bëjnë pjesë në një ose më shumë vende anëtare të Bashkimit Evropian.
5. Kufiri i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni mund arrijë një maksimum prej 25% për obligacione të cilat emetohen nga një bankë e cila ka selinë e saj të regjistruar në një vend anëtar të Bashkimit Evropian dhe i nënshtrohet me ligj mbikëqyrjes së veçantë publike e hartuar për të mbrojtur mbajtësit e obligacioneve. Në veçanti, shumat që rrjedhin nga emetimi i atyre obligacioneve duhet të investohen në përputhje me ligjin në aktive të cilat gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së obligacioneve, janë të afta të mbulojnë pretendimet që lidhen me obligacionet dhe të cilat, në rast të falimentimit të emetuesit, rimbursimi do të kryhej mbi bazën e përparësisë për rimbursimin e principalit dhe pagimin e interesit të përlogaritur.
6. Nëse një SIKTT investon më shumë se 5% të aktiveve të tij në obligacionet e përmendura në pikën 5 të këtij neni të cilat emetohen nga një emetues i vetëm, vlera totale e këtyre investimeve nuk mund të tejkalojë 80% të vlerës së aktiveve të sipërmarrjes.
7. Titujt të transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parave të përmendura në pikat 4 dhe 5 të këtij neni nuk do të merren parasysh për qëllimin e zbatimit të kufirit prej 40% të referuar në pikën 2 të këtij neni.
8. Titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të emetuara nga një emetues i vetëm, si dhe depozitat e bëra në të njëjtin institucion (emetuesi), të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni, nuk tejkalojnë 35 për qind të vlerës totale të aseteve të sipërmarrjes.
9. Kompanitë që bëjnë pjesë në të njëjtin grup për qëllime të llogarive të konsoliduara, siç përcaktohet në përputhje me dispozitat aktuale në përputhje me rregullat/standardet e njohura ndërkombëtare të kontabilitetit, do të konsiderohen si një organ i vetëm për qëllimin e llogaritjes së limiteve të përcaktuara në këtë nen.

10. Nëse synimi i politikës së investimit të SIKTT është që të replikojë një indeks aksionesh ose indeks instrumentesh borxhi specifike, Autoriteti mund të lejojë që kufiri i investimit sipas pikës 1 të këtij neni në aksione ose tituj borxhi të një emetuesi të vetëm, të shkojë deri në 20 për qind të aktiveve të sipërmarrjes që investohet.
11. Kufiri i përcaktuar në pikën 10 mund të rritet nga Autoriteti deri në 35% kur kjo është e justifikueshme nga kushtet e jashtëzakonshme të tregut dhe konsiderohet e nevojshme të rritet kufiri në mënyrë që të jetë në gjendje të replikojë një indeks, në veçanti për ato tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë që janë me peshë të madhe në indeks.

### **Neni 31**

#### **Investimi i SIKTT në obligacione qeveritare**

1. Limiti prej 35% i përcaktuar në pikën 4 të nenit 30 të kësaj rregulloreje mund të rritet deri në 100% me kusht që:
  - a) Jo më shumë se 30 % e vlerës së aktiveve të sipërmarrjes të konsistojë në tituj të një emetimi të vetëm;
  - b) Aktivët e sipërmarrjes të përfshijnë këto tituj të emetuar nga i njëjti emetues apo një emetues tjetër, me të paktën gjashtë emetime të ndryshme me numra të ndryshëm ndërkombëtarë të identifikimit të titujve (ISIN) ose të barasvlershëm të tyre; dhe
  - c) Të jetë pasqyruar ky fakt në prospektin SIKTT.

### **Neni 32**

#### **Kufizimet e Investimit të SIKTT në SIK të tjera**

1. Një SIKTT mund të blejë kuota në SIKTT ose sipërmarrje të investimeve kolektive të tjera me kushtin që jo më shumë se 10% e aseteve të saj të investohen në të njëjtën SIKTT apo sipërmarrje të investimeve kolektive të tjera.
2. Investimet e agreguara të bëra në kuota të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive, përveç SIKTT/UCITS, nuk duhet të tejkalojnë limitin prej 30% të aseteve të SIKTT.
3. Kur një SIKTT ka blerë kuota të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive, aktivët e SIK të tjera respektive nuk duhet të mblidhen për qëllimet e kufijve të përcaktuar në nenin 30 të kësaj rregulloreje.
4. Kur një SIKTT investon në kuotat e sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive ose SIKTT-ve/UCITS të tjera të cilat menaxhohen, drejtpërdrejt ose me delegim, nga e njëjta shoqëri administruese ose nga ndonjë shoqëri tjetër me të cilën shoqëria administruese ka lidhje pronësie, ajo shoqëri administruese ose shoqëria tjetër nuk do të ngarkojë tarifa

hyrje ose dalëse për investimet e SIKTT në kuotat e SIKTT/UCITS të tjera ose të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive.

5. Një SIKTT që investon të paktën 85% të aktiveve të tij në SIKTT të tjera/UCITS të tjera ose sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive do të përfshijë në prospektin e tij nivelin maksimal të tarifave të administrimit që i ngarkohen vetë SIKTT-së si dhe SIKTT-ve të tjera/UCITS ose sipërmarrjeve të investimeve kolektive në të cilat synon të investojë. Ai do të tregojë në raportin e tij vjetor përqindjen maksimale të tarifës të administrimit që i ngarkohen vetë SIKTT-së dhe SIKTT-ve/UCITS të tjera ose sipërmarrjes së investimeve kolektive në të cilën investon.

### **Neni 33**

#### **Agregimi dhe influenza**

1. Një shoqëri administruese e fondeve që vepron për llogari të të gjitha sipërmarrjeve të investimeve kolektive që administrojnë, të cilat janë sipërmarrje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, nuk mund të blejë më shumë se:
  - a) 10% të aksioneve të të njëjtit emetues;
  - b) 10% të titujve të borxhit të të njëjtit emetues;
  - c) 25% të kuotave në të njëjtën sipërmarrje të investimeve kolektive në tituj të transferueshëm;
  - d) 10% të instrumenteve të tregut të parasë nga një emetues i vetëm;
  - e) Kufizimet e përcaktuara në gërmat b, c dhe d në këtë pikë mund të mos merren parasysh në kohën e blerjes nëse në atë kohë shuma/vlera e obligacioneve ose e instrumenteve të tregut të parasë, nuk mund të llogaritet.
2. Kufijtë në pikën 1 të këtij neni mund të tejkalohen nëse:
  - a) Titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë janë të emetuara ose të garantuara nga një vend anëtar i Bashkimit Evropian ose autoritetet e tij lokale;
  - b) Titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë janë të emetuara ose të garantuara nga një vend jo anëtar i Bashkimit Evropian;
  - c) Titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë janë emetuar nga organe publike ndërkombëtare, anëtarësia e të cilave janë në një ose më shumë vende anëtare të Bashkimit Evropian.

### **Neni 34**

#### **Huamarrja për SIKTT**

1. Asnjë SIKTT, nuk mund të marrë hua me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.
2. Sidoqoftë, një SIKTT mund të blejë valutë të huaj me anë të huamarrjes së ndërsjellë midis palëve (*back to back loan*).



3. Si shmangie nga pika 1, një SIKTT mund të marrë hua me kusht që një huazim i tillë të jetë në baza të përkohshme:
  - i. Jo më shumë se 90 ditë;
  - ii. Dhe nuk përbën më shumë se 10% të vlerës neto të aktiveve të fondit

### **Neni 35**

#### **Huadhënia për SIKTT**

1. Asnjë SIKTT nuk mund të japë hua/kredi ose të përdorë aktivet e SIKTT për të vepruar si garantues për palët e treta përveç në rastin e titujve të transferueshëm, instrumenteve të tregut të parasë ose vendosjes së depozitave bankare.
2. Pika 1 e këtij neni nuk i ndalon këto sipërmarrje të investimeve kolektive të blejnë tituj të transferueshëm, instrumente të tregut të parasë ose instrumente të tjerë financiarë të përmendur në këtë rregullore, të cilat nuk janë paguar plotësisht në përputhje me nenin 36 të kësaj rregulloreje.

### **Neni 36**

#### **Investimi në tituj të paguar pjesërisht ose zero**

Në rastet kur shumat e papaguara të një titulli të transferueshëm ose të një instrumenti të aprovuar të tregut të parasë mund të konsiderohen si investim për një SIKTT vetëm nëse ka baza të arsyeshme që provojnë së kjo shumë do të paguhet nga SIKTT, kur kjo pagesë do të kërkohet, në zbatim të rregullave të këtij kapitulli.

### **Neni 37**

#### **Derivatvët mbi mallrat**

Një SIKTT nuk mund të kryejë transaksione në derivativë të mallrave.

### **Neni 38**

#### **Shfuqizimi**

Rregullorja nr. 21, datë 06.02.2018 “Për administrimin e likuiditetit për fondin e investimeve”, shfuqizohet.

### **Neni 39**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në menjëherë.

## **SHTOJCA 1**

Lista e tregjeve të rregulluara, ku titujt e pranuar për tregtim konsiderohen se e përmbushin kërkesën referuar germës b të pikës 3 të nenit 29 të kësaj rregullore.

### **Tregjet e rregulluara**

#### **Australi**

ASX (Bursa Australiane)

#### **Spanjë**

BME – Bursa e Madridit

Bursa e Barcelonës

#### **Gjermani**

Deutsche Borse Group Exchanges

- Boerse Frankfurt
- Tradegate
- China Europe International Exchange (pjesë e Deutsche Borse)
- EUREX (pjesë e Deutsche Boerse për derivativet)

#### **Bursa e Hong Kongut**

Hong Kong Exchanges & Clearing

#### **Itali**

Borsa Italiana (Euronext Group)

#### **France**

Euronext Group, Euronext Paris

#### **Belgjikë**

Euronext Group, Euronext Brussel

#### **Hollandë**

Euronext Group (Euronext Amsterdam)

#### **Poloni**

Bursa e Varshavës

#### **Austri**

Bursa e Vienës (Vienna Stock Exchange)

#### **Zvicër**

Six Swiss Exchange

#### **Suedi**

Bursa e Stockholmit (Nasdaq OMX Group)

**Danimarkë**

Nasdaq Copenhagen

**Norvegji**

Nasdaq Oslo ASA

**Finlandë**

Nasdaq Helsinki

**Vendet Balltike (Estoni, Lituani, Letoni)**

Nasdaq OMX

**Hungari**

Budapest Stock Exchange

**Greqi**

Bursa e Athinës

**Angli**

London Stock Exchange

ISDX (ICAP Securities and derivatives exchange)

BATS

**Kinë**

Shanghai Stock Exchange

Shenzhen Stock Exchange

Taiwan Stock Exchange

**Korea e Jugut**

Korea Exchange (KRX)

**Japoni**

Japan exchange group of exchanges

Tokyo stock exchange

Osaka stock exchange

**Singapor**

Bursa e Singaporit (SGX)

**SHBA**

NYSE ( New York Stock Exchange) (të gjitha bursat e grupit NYSE)

NASDAQ

**Kanada**

Bursa e Torontos

TMX Group of exchanges

TSX

**Indi**

National Stock Exchange of India (NSE)

**Arabi Saudite**

Tadawul

**Afrikë e Jugut**

Johanesburg Stock Exchange

**Zelandë e Re**

Bursa e Zelandës së Re NZX